

TAKIMI I KATËRT 2022 - KOMITETI SEKTORIAL I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Mbledhja e Komitetit Sektorial të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit u mbajt më datë **20.12.2022**.

Takimi filloi me një përmbledhje të diskutimeve të takimit të mëparshëm lidhur me gjetjet e Studimit të Nevojave për Aftësi (SNA) të tregut të punës në fushën e TIK.

Sekretariati Teknik qartësoi se, nga tabela e nevojave duhej të identifikoheshin vetëm ato nevoja që mund të përfshiheshin/realizoheshin nga arsimi profesional. U kërkua që anëtarët të bënin dy filtrime të nevojave të dala nga SNA: filtrimi i parë, çfarë mund të realizohej me kualifikime të AFP-së nga kolona e nevojave të tregut të punës dhe filtrimi i dytë, çfarë ishte e përfshirë ose jo në ofertën aktuale të AFP-së.

Mbledhja vazhdoi me diskutimin e të gjitha nevojave të dala nga studimi duke përjashtuar nevojat që nuk mund të mbuloheshin nga AFP. Analiza vazhdoi me kualifikimet profesionale të nivelit të IV të KSHK-së: **“Rrjete të dhënash”, “Programim”, “Mbështetje të përdoruesve TIK”, “Zhvillim Website”, “Multimedia”, “Rrjete të dhënash (pilot GIZ)”, “Inxhinieri Informatike Software-ike”** (4 vjeçar).

Konkluzionet:

- Për kualifikimin **“Rrjete të Dhënash”** u sugjerua që të shtoheshin më tepër orë programimi, pasi kjo konsiderohej e nevojshme për tregun e punës dhe aftësonte më tepër të rinjtë për sfidat e tregut.
- Për kualifikimin profesional **“Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”**, niveli II i KSHK-së, u sugjerua shtimi i teknologjive të ndryshme ose programeve të veçanta, si module me zgjedhje, si dhe trajtimi me kujdes dhe rëndësi i **“Cyber Security”** dhe **“Digital Marketing”**.
- Për kualifikimin profesional **“Programim”** u propozua rishikimi i gjuhës së programimit Swift dhe zëvendësimi i saj me një gjuhë programimi aktuale.
- Për kualifikimin profesional **“Inxhinieri Informatike Software-ike”** u propozua rishikimi dhe përditësimi i kurrikulës me ndryshimet e fushës, si dhe rishikimi i titullit të kualifikimit.
- Për kualifikime të reja u propozua që **“Cyber Security”** të ofrohej si një kualifikim i nivelit të V-të të KSHK-së.